

NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË SAJ

BASHKIA SHKODËR

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Shkodër
Adresa Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 - Shkodër
Tel/Faks +355 22400150
E-mail info@bashkiashkoder.gov.al
Ueb-faqe www.bashkiashkoder.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Ermal Dizdari
E-mail ermal.dizdari@bashkiashkoder.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e hapur

4. Lloji i kontratës: Pune

5. Numri i referencës për procedurën: REF-86427-11-06-2023

6. Objekti i kontratës: Fatkeqësi natyrore të menaxhuara (Reduktimi i pasojave të përmbytjes në zonën e nën Shkodrës)

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45221110-6 - Punime ndërtimi për ura

8. Fondi limit: 16,420,454 (Gjashtembdhjetemilion e katerqind e njezetmije e katerqind e pesedhete e kater) lekë pa tvsh.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Referuar gërmës c, pika 1, neni 127 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) ku citohet se "...kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër" dhe pikës 5, neni 31 "Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit" të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve kontraktore, ndodhemi në kushtet e kryerjes së modifikimeve përkatëse të kontratës. Modifikimi konsiston në shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga 28.06.2024 në 28.08.2024

Faktori kryesor i shtyrjes së punimeve janë:

1. Kushtet atmosferike me reshje shiu gjatë muajve te pare të vitit 2024 që kanë shkaktuar gjendje të nivelit të lartë të ujrave të kanaleve dhe ka realizuar mungesë tëpunimeve për ndërtimin e tombinove box.

Evidentimi i problematikave është bërë referuar shkresës nr. 13642 prot datë 26.06.2024 të sipërmarrësit të punimeve, "Rroku GUEST" sh.p.k, shkreses nr. 13641 prot datë 26.06.2024 te mbikëqyrësit të punimeve shoqerise Ing. Fatbardh Kuçi.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve.

Kontrata themelore eshte nenshkruar me datë 27.12.2023 ndersa punimet faktike sipas aktit te dorezimit te sheshit kane filluar me date 29.12.2023 dhe duhet te perfundonin 29.06.2024 brenda 6 (gjashte) muajve. Data e nenshkrimit te modifikimit eshte bere me shkresen nr. 13848 prot date 28.06.2024. Modifikimi konsiston në shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, nga data 28.06.2024 në 28.08.2024, 60 (gjashtedhjetë) dite bazuar ne problematikat e pershkuara me lart te hasura nga kontraktori gjate zbatimit te punimeve.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar: 11,444,480 leke pa TVSH(Njëmbëdhjetë milion e katërqind e dyzet e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë)

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): Nuk eshte rasti, vlera e kontrates nuk ndryshon.

13. Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashte) muaj

Dhe afati i ri (nëse është rasti): 28.08.2024 eshte afati i ri i perfundimit te punimeve

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

Emri – "Rroku GUEST" sh.p.k

NIPT: K87921701H

Adresa: Rruga Hasan Riza Pasha-Shkoder

Kontaktet rrokuguest@gmail.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit :28.06.2024

16. Burimi i financimit: nga Buxheti i Shtetit sipas VKM nr.260 datë 27.04.2023 "Për miratimin e projekteve fituese te financuara nga fondi per parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqesive natyrore , si dhe autoritetit kontraktor per zbatimin e projekteve,sipas njesive te vetqeverisjes vendore", shkreses nga Ministria e Financave nr.9022/2 prot date 15.06.2023 dhe shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19246/1 prot., dt. 31.10.2023.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: Nuk ka